



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. 4705/12 Prot

Shkodër, më 16.05.2024

KONTRATË FURNIZIMI NR.1

“Blerje e artikujve ushqimor”

REF-97585-03-06-2024


E lidhur sot me datë 16 / 05 /2024, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z.Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nr. 514, datë 29.12.2023 nga **Z.Onid Bejlari** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

Dhe operatorit ekonomik **“SEAD-SGS”sh.p.k** regjistruar ne regjistrin fillestar me nr: CN-714303-05-16 me seli te shoqerise: Tirane Lagjia Kashar Nr.2,Rruga “Mullishter”; godine 1-kateshe; Nr. Pasurie 4, ZK 2105 me NUIS **L61725018G**, me perfaqesues ligjor te shoqerise **Z.Entela Lici** me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin kontraktor, Bashkia Shkoder për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **“Kontraktuesi”**

Neni 1

Baza ligjore

- Kodi Civil ligji nr.7850, dt. 29.07.1994, i ndryshuar,
- Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, I ndryshuar
- VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,e ndryshuar
- Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar.
- Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”
- Marreveshja kuader nr.4705/11 date 14.05.2024



Neni 2

Objekti i kontratës

- 2.1. Objekt i kësaj kontrate është furnizimi me objekt: “ **Blerje e artikujve ushqimor** ” në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit dhe që **Kontraktuesi – ”SEAD-SGS”sh.p.k**, pranon t’i dorëzojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit.

Neni 3

Vlefë e kontratës

- 3.1. Kontraktuesi merr përsiper të dorëzojë tek Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër mallin sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlerë totale prej **9,555,581** (Nentemilion e pesëqind e pesëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa tvsh ose **11,466,697.2**(Njembëdhjetemilion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e nentëdhjetë e shtatë pike dy) lekë me tvsh i detajuar si me poshte:
- Vlera e kontratës per **kopshtet** është **6,412,749**(Gjashtëmilion e katërqind e dymbëdhjetemijë e shtatëqind e dyzet e nente) leke pa tvsh dhe **7,695,298.8**(Shtatëmilion e gjashtëqind e nentëdhjetë e pesëmijë e dyqind e nentëdhjetë e tete pike tete) leke me tvsh
 - Vlera e kontratës per **çerdhet** është **3,142,832**(Tremilion e njëqind e dyzet e dymijë e teteqind e tridhjetë e dy) leke pa tvsh dhe **3,771,398.4**(Tremilion e shtatëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e treqind e nentëdhjetë e tete pike kater) leke me tvsh
- 3.2. Financimi realizohet nga Buxheti i Bashkisë viti 2024 i miratuar me VKB nr.55 datë 29.12.2023”Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor Afatmesëm perfundimtar 2024 - 2026 te Bashkisë së Shkodrës”.
- 3.3. Çmimet e kontraktorit për mallrat e furnizuara sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.
- 3.4. Çmimet për njësi janë percaktuar në Formularin e Çmimit të Ofertës si me poshte:

Nr	Përshkrimi I Mallit	Njësia e Matjes	Sasia Kopshte deri me 31.12.2024	Çmimi për Njësi	VLERA
1	Buke Integrale	kg	5,200.00	120	624,000.00




2	Mish pule	kg	845.00	310	261,950.00
3	Mish viçi	kg	1,625.00	720	1,170,000.00
4	Sheqer	kg	975.00	92	89,700.00
5	Oriz	kg	975.00	130	126,750.00
6	Makarona	kg	1,300.00	140	182,000.00
7	Miell gruri	kg	975.00	80	78,000.00
8	Miell misri	kg	325.00	150	48,750.00
9	Kripe	kg	163.00	35	5,705.00
10	Vaj ulliri	liter	1,300.00	480	624,000.00
11	Reçel kumbulle	kg	195.00	220	42,900.00
12	Reçel	kg	195.00	250	48,750.00
13	Kos	kg	1,300.00	115	149,500.00
14	Gjize pa kripe	kg	325.00	180	58,500.00
15	Qumesht	Liter (kuti)	7,800.00	110	858,000.00
16	Djathe I bardhe	Kg	1,300.00	500	650,000.00
17	Veze	kokerr	35,750.00	14	500,500.00
18	Patate	kg	1,950.00	65	126,750.00
19	Qepe e thate	kg	455.00	100	45,500.00
20	Karrota	kg	618.00	70	43,260.00
21	Kunguj	kg	91.00	60	5,460.00
22	Domate	kg	350.00	80	28,000.00
23	Kastraveca	kg	130.00	80	10,400.00

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web:www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al




24	Brokuli	kg	111.00	150	16,650.00
25	Lulelaker	kg	111.00	150	16,650.00
26	Bizele	kg	163.00	170	27,710.00
27	Spinak	kg	325.00	70	22,750.00
28	Presh	kg	273.00	70	19,110.00
29	Pluhur pjekes	16 gr	176.00	17	2,992.00
30	Vanilje	16 gr	176.00	17	2,992.00
31	Arre muskat	40g	65.00	170	11,050.00
32	Selino	40g	65.00	150	9,750.00
33	Kanelle	40g	65.00	150	9,750.00
34	Thjerza	0.5 kg	221.00	160	35,360.00
35	Tershere	500 gr	163.00	120	19,560.00
36	Trahana	0.23 kg	234.00	50	11,700.00
37	Rigon	50 gr	65.00	130	8,450.00
38	Majdanoz	50 gr	65.00	20	1,300.00
39	Hudra	kg	52.00	250	13,000.00
40	Limon	kg	52.00	100	5,200.00
41	Banane	kg	585.00	160	93,600.00
42	Molle	kg	260.00	80	20,800.00
43	Portokalla	kg	130.00	100	13,000.00
44	Fruta te stines	kg	2,340.00	75	175,500.00
45	Fasule	kg	325.00	240	78,000.00



46	Qese plasmasi	pako	130.00	150	19,500.00
	Vlera pa TVSH				6,412,749.00
	TVSH 20 %				1,282,549.80
	Vlera me TVSH				7,695,298.80


Nr	Përshkrimi I Mallit	Njësia e Matjes	Sasia Çerdhe deri me 31.12.2024	Çmimi për Njësi	VLERA
1	Buke Integrale	kg	2,275.00	120	273,000.00
2	Mish pule	kg	195.00	310	60,450.00
3	Mish viçi	kg	325.00	720	234,000.00
4	Mish I grire	kg	130.00	400	52,000.00
5	Sheqer	kg	650.00	92	59,800.00
6	Oriz	kg	520.00	130	67,600.00
7	Makarona	kg	650.00	140	91,000.00
8	Miell gruri	kg	228.00	80	18,240.00
9	Miell orizi	0.25 kg	325.00	70	22,750.00
10	Drithera	kg	325.00	500	162,500.00
11	Kripe	kg	130.00	35	4,550.00
12	Vaj ulliri	liter	520.00	480	249,600.00
13	Reçel kumbulle	kg	195.00	220	42,900.00
14	Reçel	kg	163.00	250	40,750.00
15	Kos	kg	975.00	115	112,125.00

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web.www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



16	Gjize pa kripe	kg	228.00	180	41,040.00
17	Qumesht	Liter (kuti)	7,150.00	110	786,500.00
18	Djathe I bardhe	Kg	98.00	500	49,000.00
19	Djathe Kackavall	Kg	65.00	850	55,250.00
20	Veze	kokerr	5,200.00	14	72,800.00
21	Salce	0.7 kg	228.00	110	25,080.00
22	Patate	kg	975.00	65	63,375.00
23	Qepe e thate	kg	195.00	100	19,500.00
24	Spec I kuq	kg	98.00	120	11,760.00
25	Karrota	kg	228.00	70	15,960.00
26	Kunguj	kg	130.00	60	7,800.00
27	Domate	kg	400.00	80	32,000.00
28	Kastraveca	kg	150.00	80	12,000.00
29	Brokuli	kg	130.00	150	19,500.00
30	Lulelaker	kg	117.00	150	17,550.00
31	Bizele	kg	65.00	170	11,050.00
32	Qiqra	05. kg	65.00	170	11,050.00
33	Spinak	kg	130.00	70	9,100.00
34	Pluhur pjekes	16 gr	98.00	17	1,666.00
35	Vanilje	16 gr	98.00	17	1,666.00
36	Koper	40g	65.00	125	8,125.00
37	Selino	40g	65.00	150	9,750.00

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web.www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



38	Kanelle	40g	65.00	150	9,750.00
39	Thjerza	0.5 kg	117.00	160	18,720.00
40	Tershere	0.5 kg	260.00	120	31,200.00
41	Trahana	0.23 kg	260.00	50	13,000.00
42	Rigon	50 gr	65.00	130	8,450.00
43	Borzilok	50 gr	65.00	150	9,750.00
44	Majdanoz	50 gr	65.00	20	1,300.00
45	Hudra	kg	33.00	250	8,250.00
46	Limon	kg	65.00	100	6,500.00
47	Banane	kg	585.00	160	93,600.00
48	Molle	kg	130.00	80	10,400.00
49	Portokalla	kg	98.00	100	9,800.00
50	Dardha	kg	98.00	150	14,700.00
51	Fruta te stines	kg	975.00	75	73,125.00
52	Fasule	kg	195.00	240	46,800.00
53	Qese plasmasi	pako	98.00	150	14,700.00
	Vlera pa TVSH				3,142,832.00
	TVSH 20 %				628,566.40
	Vlera me TVSH				3,771,398.40



Neni 4

Afat i kontratës

- 4.1. Kontrata nr.1 do të realizohet nga nenshkrimi i saj nga palet deri me **31.12.2024** ne zbatim te marreveshjes kuader nr.4705/11 date 14.05.2024 me afat 12(dymbedhjete) mujor.

Neni 5

Gjuha e kontratës

- 5.1 Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

Neni 6

Qëllimi

- 6.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 6.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 7


Përkufizimet

7.1 Kontrata

- 7.1.1 “Kontrata” do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.



- 7.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.
- 7.1.3** "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.
- 7.1.4** "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- 7.1.5** "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 31.
- 7.1.6** "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Mallrave objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- 7.1.7** "Vizatimet" do të thotë vizatimet e Mallrave, siç janë përfshirë në Kontratë, dhe çdo vizatim shtesë dhe i modifikuar i lëshuar nga (ose në emër dhe për llogari të)
- 7.1.8** Blerësit në përputhje me Kontratën.
"Katalog" do të thotë një "libër" që përmban listën e produkteve/mallrave përfshirë përshkrimet e cilësive/specifikimeve, si dhe mënyrën e përdorimit të tyre.
- 7.1.9** "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuar nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë. Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.
- 7.1.10** "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.
- 7.1.11** "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 7.1.12** "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.
- 7.2 Palët e Kontratës**
- 7.2.1** "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.
- 7.2.2** "Blerës" do të thotë Autoriteti Kontraktor përfituesi i Mallrave objekt kontrate.
"Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që furnizon Mallrat objekt kontrate.
- 7.2.4** "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për ofrimin e një pjese të Mallrave ose Shërbimeve të Lidhura me to.
- 7.3 Datat, Testet, Periudhat dhe Përfundimi**
- 7.3.1** "Test i Pranimit" do të thotë testet (nëse janë të aplikueshme) të cilat janë specifikuar në Kontratë dhe që kryhen në përputhje me Specifikimet për qëllimin e pranimit të Mallrave.
- 7.3.2** "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.



7.4 Mallrat

- 7.4.1** "Mallra" do të thotë të gjitha mallrat, lënda e parë, makineritë dhe pajisjet dhe / ose materialet e tjera që Furnizuesit duhet t'i furnizojnë Blerësit sipas Kontratës.
- 7.4.2** "Shërbime të Lidhura" do të thotë shërbimet e rastit të lidhura me furnizimin e Mallrave, siç janë sigurimi, transporti, instalimi, vënia në punë, trajnimi dhe mirëmbajtja fillestare ose ndonjë shërbim tjetër i kësaj natyre sipas Kontratës.

7.5 Përkufizime të tjera

- 7.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.
- 7.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 28 "Forca Madhore".
- 7.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 17 "Sigurimi i Kontratës".
- 7.5.4** "Vendi i dorëzimit të Mallrave", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.
- 7.5.5** "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.
- 7.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 29.
- 7.5.7** "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK
- 7.5.8** "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.


7.6 Interpretimi

- 7.6.1** Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

- (a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
- (b) fjalët që tregojnë njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjës;
- (c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
- (d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

7.6.2 Inkotermat

- (a) "Inkotermat" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- (b) Përveçse kur nuk është në përputhje me ndonjë dispozitë të Kontratës, kuptimi i çdo termi tregtar dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve në të do të jenë siç përshkruhet nga Inkotermat.



(c) Inkotermat, kur përdoren, rregullohen nga rregullat e përshkruara në botimin aktual të Inkotermave, të specifikuara në KVK, dhe të publikuara nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

7.6.3 Modifikimi

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

7.6.4 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

7.6.5 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

7.7 Komunikimet

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rena dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:


(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

7.8 Ligji dhe gjuha

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi. Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.



Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

7.9 Prioriteti i Dokumenteve

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

7.10 Hartimi i Kontratës

7.10.1 Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

7.10.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

7.11 E drejta e autorit

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha vizatimet, dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

7.12 Detaje Konfidenciale

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Mallrave të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.



Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

7.13 Pajtueshmëria me ligjet

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:


~~(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkojnë për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;~~

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) të neni 7.13 këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penalteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cenuar Nenin 14.1

7.14 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidarë

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

7.15 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi



Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluar, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën. Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Hartimi i Kontratës

- 8.1** Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 8.2** Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.
- 8.3** Bashkëlidhur kontratës do të jenë oferta dhe specifikimet teknike të mallrave objekt i kësaj kontrate.

Neni 9

Praktikat e ndaluara

- 9.1** Furnizuesi nuk /do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluar në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.
- 9.2** Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohet më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.
- 9.3** Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

Neni 10

Njoftimet

- 10.1** Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.
- 10.2** Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 11

Objekti i Furnizimit

- 11.1** Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të furnizohen duhet të jenë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe të jenë



- 11.2** të shoqëruara me fletë analizat përkatëse dhe përcaktohet origjina e mallit për gjitha produktet.
- Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

Neni 12

Dorëzimi

- 12.1** Dorëzimi i Mallrave dhe Përfundimi i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuar në Dokumentet e Tenderit dhe të jenë të shoqëruara me fletë analizat përkatëse dhe përcaktohet origjina e mallit për gjitha produktet.

Neni 13

Përgjegjësitë e Furnizuesit

- 13.1** Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në Objektivin e Furnizimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe të jenë të shoqëruara me fletë analizat përkatëse dhe përcaktohet origjina e mallit për gjitha produktet.

Neni 14

Çmimi i Kontratës

- 14.1** Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 27.

Neni 15

Kushtet e Pagesës

- 15.1** Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.
- Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Mallrat e dorëzuara dhe Shërbimet e Lidhura me to të kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.
- 15.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkesë për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

- 15.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.
- 15.4** Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Neni 16

Tatimet, Taksat dhe Detyrimet e tjera

- 16.1** Për Mallrat e prodhuara jashtë vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, taksat e pullës, tarifat e licencës dhe detyrime të tjera të tilla të vendosura jashtë vendit të Blerësit.
- 16.2** Për Mallrat e prodhuara brenda vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, detyrimet, tarifat e licencës, etj., të lindura deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara tek Blerësi.
- 16.3** Nëse në vendin e Blerësit, mund të jetë i disponueshëm për Furnizuesin ndonjë përjashtim, ulje, lejim ose favor tatimor, Blerësi duhet t'i krijojë mundësi Furnizuesit të përfitojë nga këto lehtësira.

Neni 17

Sigurimi i Kontratës

- 17.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.
- 17.2** Në përputhje me Nenin 17.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.
- 17.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.
- 17.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

Neni 18

Nënkontraktimi

- 18.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.
- 18.2**



- 18.3** Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit Parashikimet e Nenit 9 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

Neni 19

Specifikimet dhe Standardet


- 19.1** Furnizuesi duhet të sigurojë që Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura të jenë në përputhje me Kërkesat Teknike, siç specifikohet në Dokumentet e Tenderit të jenë të shoqëruara me fletë analizat përkatëse dhe përcaktohet origjina e mallit për gjitha produktet.
- 19.2** Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Blerësi, me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Furnizuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Blerësin për të.
- 19.3** Kudo që bëhen referenca në Kontratë për kodet dhe standardet, në përputhje me të cilat do të ekzekutohet, shtesa ose versioni i rishikuar i kodeve dhe standardeve të tilla, do të jenë ato të specifikuara në kërkesat e dokumenteve të tenderit. Çdo ndryshim në cilindo kod dhe standard, gjatë ekzekutimit të Kontratës, do të zbatohet vetëm pas miratimit nga Blerësi dhe do të trajtohet në përputhje me Nenin 29 të këtyre kushteve dhe dispozitat e LPP-së për modifikimin e Kontratës, Neni 127.

SPECIFIKIME TEKNIKE PER ARTIKUJ TE NDRYSHEM USHQIMORE

BUKE INTEGRALE

Bukë integrale me miell integral, cilësi e parë. Treguesit shqisorë Pamja : E rregullt, pa shtypje, pa deformime, pa shenja djegie Mielli nuk duhet te kete asnje lloj lende te huaj.Ngjyra : karakteristike e llojit te bukes integrale kafe e erret. Konsistenca: Elastike me shtypje të lehte, rikthehet ne gjendjen e parë, jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa. Poret të jenë të shpërndara njëllor në të gjithë madhësinë. Era dhe shija: e këndshme, e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj. 12 Nuk lejohet kercitje. Këto tregues përcaktohen me anë të analizës organo-leptike.

Tuli duhet te jete i pjekur mire, me porozitet te imet ne te gjithë vellimin e tij dhe nuk duhet te kete gjurme mielli te pabrumosura. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me ere te huaj, me shije te hidhur e te tharte, me lende te huaja, me lageshtire jo normale, me shije myku.



Treguesit fiziko – kimik: Buka preferohet ne forme katerkendeshe dhe me peshe 1(nje) kg, lageshtira jo me shume se 44.5 %, poroziteti jo me pak se 72%, aciditeti jo me shume se 45%. Furnizimi i bukes do te behet cdo dite prane magazinave se bashkisë sipas kerkeses. Amballazhi i transportimit te bukes duhet te jete i paster dhe te siguroje mos demtimin e saj. Mjetet transportuese duhet te jene te pastra, te mbyllura qe te sigurohet transportim normal i bukes deri ne destinacionin perkates.

MISHI

Mish vici i fresket

Mishi duhet te jete brenda standarteve shteterore dhe i certifikuar per konsum. Te jete mish i freket vendi, pa ere, te jete i forte, kufome ose kofshe e pasme (trung), me peshe jo me te madhe se 100 kg, Pamja e jashtme te jete me siperfaqja e jashtme e mbuluar me nje cipe te holle tharje, siperfaqja e mishit te ftohur menjehere pas prerjes te jete i tejdukshem, tendinat te jene te ndritshme, elastike dhe te forta. Mishi te jete me ngjyre roze dhe i dhjamt te jete me ngjyre te bardhe. Me ere te kendshme, karakteristike e llojit. Çdo furnizim damkoset me vulen e kontrollorit veterinar e sanitar dhe me vulen e llojit e te cilesise se mishit. Çdo parti mishi shoqerohet me çertifikaten veterinare me te cilen vertetohet gjendja e tij e mire shendetsore per shitje ne treg (konsum). Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri ne magazinat e bleresit.

MISH PULE

Pamja e jashtme: Me ngjyrë rozë e çelur që anon në të bardhë karakteristike e mishit të pulës së freskët, pa shtresa të tepërta dhjami, cilësi e parë. 2. Ndarja anatomike: Mishi i pulës do të përbëhet nga te gjithë pjeset e pules(jo vetem kofsha ose pjese te tjera te ndara). 3.Kontrolli veterinar: Pulat të jenë të shoqëruara me çertifikatë veterinare dhe shëndetsore nga veterinerë shtetërorë. Paketimi të jetë me kuti kartoni ku të jetë shënuar pesha dhe data e skadencës. Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

MISH I GRIRË

Te jete i fresket, prodhim vendi. Mishi i grire te jete i cilesise se pare, te jete i kulluar mire, nga pjese kofshe te vicit ,i shoqeruar me raport analize nga Inspektoriati Veterinar, me vule ne mish, me perqindje te ulet dhjami dhe Transporti te behet me mjete frigoriferike te licensuara nga inspektoriati Veterinar.

BULMETRA

QUMESHTI



Te jete i fresket, i pasterizuar dhe i sterilizuar. Te mos kete ne permbajtjen e tij lende konservuese dhe neutralizuese. Te plotesoje treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike. Ambalazhimi te jete brenda kushteve higjeno-sanitare. Ruajtja dhe transportimi me temperature 2 deri ne 8 grade. Permbatja e yndyres deri ne 2-3 %

KOS


Kërkesat per produktet cilësore - Ngjyra: e bardhe, në siperfaqe e bardhe lehtesisht në krem. - Struktura: e ngjeshur, pa pore, ne prerje pa shtresa dhe ndarje hirre. - Era dhe shija: e kendeshme, karakteristike e kosit te embel, lehtesisht e tharte. Ambalazhimi,marketimi dhe etiketimi Kosi ambalazhohet ne paketim tetrapack, shishe qelqi ose plastike, me grykë të gjerë, me mase 1 kg te mbyllur me kapak. Ambalazhet qe perdoren te jene ne gjendje te mire,te paster,te thata dhe pa ere te huaj. Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjenosanitare nga standardet përkatëse. Ruajtja dhe transporti: Kosi ruhet e tregëtohet në frigorifer në temperaqtura nën 100 C dhe në mungesë të tyre mbahet në mjedis të freskët dhe të ajrosur.

DJATHE I BARDHE

Djathi kerkohet me baze prodhim neprodukt i qumeshtit te , deles, ose dhise. Nuk lejohet prodhim i djathit me perzierje qumesht pluhur ose te kodensuar. Ngjyra te jete sipas llojit te qumeshtit , i deles dhe dhise te kete ngjyren kerkteristike te qumeshtit i bardhe (kur djathi eshte prodhuar me baze qumeshti delje ose dhie,) Lejohet djathe me perqindje yndyre jo me shume se 3 %. Pamja e jashtme te jete konforme, ne brendesi poroze karekteristike e djathit te stazhionuar mire. Sasia e kripes te jete normale. Shija te jete e mire karekteristike e djathit normal pa erera te tjera jo te kendshme. Ambalazhimi te jete i shoqeruar deri 10 – 14 % kripe deti te jete i abalazhuar ne kuti brenda standarteve,kutite te jene 1 kg. Nuk lejohet me afat skadence me shume se nje vit. Malli te jete i shoqeruar me certifikate te cilesise dhe te standarteve te miratuara. Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit, data e stazhionit dhe data e skandences.

DJATH KAÇKAVALL

Me kore të formuar mirë dhe të pastër. Nuk lejohen dëmtime biologjike, shenja myku, kalbëzime dhe fryrje. Djathi kaçkavall të jetë i stazhionuar dhe i perpunuar brenda kushteve teknologjike, prodhuar me qumesht lope, cilesia I. - Forma: Prizem, trekendore faqe anesore cilindrike - Pamja e jashtme: E formuar mire, e paster pa njolla, pa lende te huaja. - Shija dhe era: E kendshme dhe specifike e llojit të djathit të stazhionuar, pa shije te hidhur dhe djegese dhe pa shije dhe ere te huaj.



GJIZE E FRESKET DHE PA KRIPE

Cilesia e parë pamja e pastër, me ngjyrë të bardhë, lehtësisht në gri. Struktura: e njellojte ne te gjithë masen, pa therrime djathi. Era dhe shija të jetë e kendeshme, karakteristike e gjizes se fresket, lehtësishte ne te embel, pa shije thartire. Treguesit fiziko kimikë: 1-Lageshtira ne % , jo me shume se 68 2-Yndyrë ne e %, jo me pak se 3. Analiza mikrobiologjike 7 Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shendetesise. - E-coli 100-1000 cfu/ml Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Raport Analiza "Fiziko-Kimike" dhe "Raport Analiza Mikrobiologjike" duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara. Ambalazhimi: Gjiza e fresket ambalazhohet ne vasketa plastike të valezuar me mase 1 kg. (sipas kerkeses se entit). Mbi cdo ambalazh me gjize vendoset etiketa ne të cilen shenohen: Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit. Pesha neto ose vëllimi i produktit. Data e prodhimit. Data e skadencës. Kushtet e vecanta të ruajtjes. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkeputet nga ambalazhi. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

USHQIME TE NDRYSHME

Vezet

Veze pule , te pastra e jo te plasarituiara te cilesise se pare.Te jene prodhim i fresket brenda dy ditesh te shoqeruara me dokumentin perkates te prodhimit.Te jene te amalazhuara me karton fole dhe ne kuti kartoni. Jo me te vogla se 50-60 gram .

Makarona


Ngjyra e e bardhe ne te verdhe e cilesise se pare.E paketuar ne pako gjysem kilogrameshe dhe me etiken perkatese te garancise dhe te prodhuesit.Pako te pa demtuara. Ere e kendeshem e makaronave te fresketa gjate gatimit.Tipi makaronit do te jete sipas kerkeses per natyren e gatimit.Nuk perjashtohet kerkesa llojit te prodhimit. Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Miell gruri

te jete cilesor , me Rreze 70-75 % , i bardhe, i paster, i etiketuar sipas standartit shtetror dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit. Ambalazhimi te jete me pako në kg.

Miell misri

Ngjyra: E verdhë ose e bardhë sipas llojit të misrit. - Era dhe shija: Karakteristikë e miellit të misrit. Shija lehtësisht e ëmbël, pa shije të thartë, të hidhur dhe pa erë



myku e çdo shije e erë tjetër e huaj. Nuk lejohet kërcitje. Lëndë minerale nuk lejohen. - Mikroorganizma, patogjene, infestime dhe dëmtues hambari të gjallë nuk lejohen. - Ambalazhimi, ruajtja dhe transportimi Ambalazhimi ne pako letre ose plastike me masë sipas kërkesave të AK-së. Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shenohen të dhenat e mëposhtme. Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Miell orizi

Ngjyra: E bardhe me nuance ngjyre te verdhe Era dhe shija: Karakteristike e miellit te orizit, pa shije te tharet e te hidhur, pa ere te mykur dhe ere tjeter te huaj. Treguesit fiziko- kimike: Lageshtia: 12.8% Aciditeti 0.081% Lende te huaja jo me shume se 0.2% Lende minerale nuk lejohen. Ambalazhimi i paketuar ne qese letre me peshe 0.25 kg Marketimi: Emertimi i prodhuesit Emertimi i produktit. Pesha neto Data e skadimit Kushtet e vecanta te ruajtjes Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit. Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Oriz

I cilesise se pare, te jete i paster pa lende te huaj, i imet me kokerr te plote te pa thyer ,i paketuar ne cese nje kilogrameshe dhe ne kuti kartoni me etiken e prodhuesit dhe te afatave te garancise. Pa shenja te ndrysheme myku apo te tjera te kesaj natyre prishjeje. Ambalazhimi te mos jete i demtuar.

Ne pershtatje me natyrene e ushqimit te kijet parasyshe marka qe do te kerkohet. . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Drithera

Të dhëna për produktin e kërkuar: Drithra të pasuruara me hekur, te cilat përzihen me ujë dhe janë ushqim i përshtatshëm për foshnjat nga 6-12 muaj. Produkti të jetë I certifikuar nga vendi i origjinës. 2. Çertifikatë veterinare eksporti ku të jetë përcaktuar destinacioni "Shqipëri" dhe subjekti importues. 3. Raport analizë mikrobiologjike, (nga AKU ose ISUV) 4. Analiza Toksikologjike – aflatoksin

Thjerreza

me paketim 0.5 kg ,te jene cilesore dhe me date skadence 6 muaj nga momenti i furnizimit.

Trahana

Trahana e cilësisë Pamja: Mase kokrrizore e mielllore. Pas zierjes paraqitet mase e lidhur e njetrajtshme. Shija dhe era :E kendshme karakteristike e trahanase pak e tharte .Pa ere e shije myku .Trahanaja paketohet ne qese plastike ose letre me mase 0.23 kg.

Tërshërë:

Pamja e jashtme: të jetë kokërr tërshërë e shtypur, e pastër pa insekte dhe përzierje të huaja. b. Ngjyra: e bardhë në te verdhë të çelur. c. Shija dhe era: pa shije dhe erë

myku apo erë dhe shije tjetër të huaj. d. Dëmtues të gjallë: nuk lejohen. Ambalazhimi: i pakeluar me pako me peshë 500 gr. Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa në të cilën shënohen: • Emërtimi i prodhuesit. • Emri i produktit . • Pësia neto ose vëllimi i produktit. • Data e prodhimit . • Data e skadimit. • Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Sheqer

Ngjyre te bardhe me shkelqim,i embel te tretet lehtesisht .

Te jete i cilesise se pare me kristale te imta te mos kete lageshtire(deri 0.074).I pakeluar ne paketa nje kilogrameshe me etiken e prodhuesit ku te kete dhe afatet e skadences dhe i sitemuar ne kuti kartoni. Ambalazhimi te mos jete i demtuar . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

Recel të frutave të ndyshme

te jete i fresket ne kushte optimale per konsumim ne sasine 0.9.kg me afat skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit. Te mos jete FIKU, te jete cilesor, me ngjyre dhe shije karakteristike,i etiketuar sipas standartit shteteror. Te jete I ambalazhuar ne ene te mbyllura hermetikisht, jo me te medha se 1 kg, me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU.

Reçel kumbulle:

te jete i fresket ne kushte optimale per konsumim ne sasine 1.kg me afat skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit. Te jete cilesor, me ngjyre dhe shije karakteristike,i etiketuar sipas standartit shteteror. Te jete I ambalazhuar ne ene te mbyllura hermetikisht, jo me te medha se 1 kg, me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU.

Reçel qershi:

te jete i fresket ne kushte optimale per konsumim ne sasine 1 kg me afat skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit. Te jete cilesor, me ngjyre dhe shije karakteristike,i etiketuar sipas standartit shteteror. Te jete I ambalazhuar ne ene te mbyllura hermetikisht, jo me te medha se 1 kg, me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU.

Vaj ulliri (BIDONA 1 LITROSH):

Te jete nenprodukti ullirit, me aciditet te ulet i kulluar, i rafinuar, te mos kete papasterti. Ambalazhimi te jete ne shishe plastike 1 lit. dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit

Kripe

E barshe e plote, me kristale te imeta , e treteshme lehte ne uje dhe ne gjelle.

E pakeluar ne cese plasmasi te rregullta (te pa demtuara) 1 kg dhe e ambalazhuar ne kuti



kartoni. Te jene te etiketuara me te dhenat e garancise dhe te prodhuesit . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit.

FRUTA E ZARZAVATE

Molla

Kerkohet cilesia e pare, me forme, ngjyre e shije te kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike te njejte, te shendosha, te pastra, te zhvilluara normalisht, pa ere e shije te huaja. Lejohen edhe kokrra pa bisht, por pa difekte rreth bishtit. Madhesia e kokrrs te jete jo me pak se 60 mm ne prerje ne gjatesi.

Kanellë

Lloji: pluhur Treguesit shqisorë - Pamja: Pluhur i thatë, e shije dhe erë karakteristike të kanellës. - Ngjyra: E kuqërremtë. - Nuk lejohen papastërti te ndryshme. Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Data e skadimit të jetë e përcaktuar.

Selino

Lloji : cilësi e parë, e freskët, të pastra të freskëta, me gjethe të pa çara e të pa zverdhura, me ngjyrë karakteristike të kultivarit. Për selinon (rrënjët) të jenë të formuara e të padëmtuara. - Dëmtime, sëmundje: Nuk lejohen. Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Transporti i produkteve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Portokalli

Kerkohet cilesi e pare, i fresket, me zhvillim normal, te shendoshe e me bisht. Pra dhe mbas 15 janarit lejohet kokrra pa bisht, perkatesisht 5 & 20 %, me pjekuri teknike te plote. Ngjyra te jete karakteristike e kultivarit, e verdhe ne portokalli, me ere karakteristike dhe shije te embel ne te athet, pa shije te hidhur. Madhesia e kokrrs te jete jo me pak se 70 mm. Demtime mekanike nuk lejohen. Te prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen. Lende te huaja nuk lejohen. Gervishje ne sipërfaqe por pa prekur tulin, nuk lejohen. Zbutje te kokrrave, ngrirje dhe lagje te sipërfaqes se tyre nuk lejohen.

Banane

Kerkohet cilesi e pare e fresket e pjekur mire ,me ngjyre te verdhe, pa shenja dhe demtime pa shtypje

“DARDHA”

Kërkohet cilësia e parë, me zhvillim normal, të shëndosha, me ngjyrë karakteristike të kultivarit, me pjekuri teknike dhe me bisht. b. Madhësia e kokrrës:

të jetë jo më pak se 45mm për dardhat e rrumbullakta dhe 40 mm për ato të gjata. Sëmundjet: nuk lejohen. e. Dëmtime nga bryma, ngrica, të lagura dhe lëndë të huaja: nuk lejohen. Ambalazhimi: të ndara sipas kultivareve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra.

“LIMONI”

Pamja e jashtme: të freskët, me zhvillim normal, të shëndoshë dhe me bisht. b. Ngjyra, shija dhe aroma: ngjyrë karakteristike e kultivarit e verdhë në portokalli me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të athet, pa shije të hidhur.

Frutat e stinës

Të jenë të freskëta, me zhvillim normal, të shëndosha, me ngjyrë karakteristike të kultivarit, me pjekuri teknike. Ambalazhimi: të ndara sipas kultivareve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra.

ZARZAVATE

Kastravec

Kastraveca per treg cilesia e parë, të fresket me ngjyre e forme tipike të kultivarit , me perkulje të lehte . Perberja e brendshme e tulit: Me tul të forte e të lengshem. Farat e pa zhvilluara e pa kore të forte. Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88. Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Domate

Kerkohet domate e cilesise se pare, ku te jene te fresketa, me forme tipike te kultivarit, te plota, te pastra, te pa vrara, te pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga diegia e diellit, te pa prekura nga semundjet dhe demtuesit si dhe te pa lagura. Pjekuria duhet te jete normale, me ngjyre te kuqe, lehtesisht roze dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate te tejpjekura, te zbutura e te vyshkura. Dëmtime e semundje nuk lejohen. Te plasura e te vrara lehtesisht per llojet e mesme e te vona lejohet deri ne 5 % plasaritje rreth bishtit, por pa rrjedhje lengu. Madhesia e kokrres te jete: Per te hershmet 3-4 cm. Per te mesmet e te vonat 7 cm.

Speci i kuq

Lloji i cilësi e parë, e freskët Pamja e jashtme: Me ngjyrë te kuqe e formë tipike të kultivarit, të freskëta, të pastra dhe me pjekuri teknike. - Dëmtime (të shtypura, të gërvishtura) nuk lejohen -. Nuk lejohet përzierje e specave djegës me ato jo djegës.

Borzilok

Pamja e jashtme: të jetë i freskët, me ngjyrë jeshile të errët, pa dëmtime, pa lëndë të huaja, pa elemente të kalbur. Me sëmundje: nuk lejohen . Ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas



standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi. Çdo parti perimesh shoqërohet me etiketë ku shënohet: • Prodhuesi. • Lloji i prodhimit. • Cilesia.

Karrota

Lloji :Karrota per treg cilesia e pare. Kerkesat cilesore : Pamja e jashtme: Të fresket me ngjyre e forme tipike të kultivarit , me perkulje të lehte.

Spinaq

Kerkohet cilesia e pare, te jete I fresket I paster me gjethe jo te vyshkura, ngjyra e gjethit te jete jeshil,pa semundje,Forme tipike kultivarit.

Presh

per treg cilesia e pare. -Pamja e jashtme.i fresket, i paster, i njome , me ngjyre të bardhe ne jeshile , i pavyshkur dhe i lare me uje të pijshem . -Diametri ne pjesen me të trashe, cm.Mbi 2.5-3.5cm . -Gjatesia e kercellit ne cm.25-45 . -Gjatesia e

gjethit nga rozeta ,cm, jo me shume se 20cm -Sistemi rrenjor ,cm,jo me shume se 1cm. -Demtime e semundje.Nuk lejohen . Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88. Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi. Çdo parti perimesh shoqërohet me etikete ku shenohet: Prodhuesi. Lloji i prodhimit. Cilesia . Masa bruto dhe neto. Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

Bizele

per treg cilesia e pare. - Pamja e jashtme .Të njoma, të fresketa,të pastra e të pacara, me ngjyre të kultivarit ,me pjekuri teknike dhe madhesi normale të kultivarit. - Kokrrat ne bishtaje te madhesise normale të kultivarit ,të zhvilluara mire ne fazen qumeshtore, me ngjyre jeshile të hapur ,me lekure të holle ,të njome e të embel , pa shenja drunjezimi . Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88. Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi. Çdo parti perimesh shoqërohet me etikete ku shenohet.

Majdanoz

Kerkohet cilesi e pare, i fresket , i njome, i paster me ngjyre jeshile te erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, i lidhur ne tufa.

Me rrenje te prera. Te mos kete prani te barnave te tjera. Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, te frasketa dhe te pa vyshkura.

Patate

Te e cilesise se pare me diameter jo me te vogel se 5 cm , e pa demtuar apo e kalbur.e paster me ngjyre e bardhe ne te verdhe.

Madhesia mesatare , e re ne prodhim, te jete normale ne gatim

E ambalazhuar ne thase jo te mbydhur(tip rrjete)ne peshe deri 15 kg.



Preferohet prodhimi vendas.

Lulelaker

Kerkohet cilesi e pare te jene te fresketa te mos kete shenja demtimi,te kete ngjyren e bardhe karakteristike te saj,madhesia e lulelakres te jete me peshe mesatare.

Borokoli

Kerkohet cilesi e pare te jene te fresketa te mos kete shenja demtimi ose vyshkje te kete ngjyren jeshile karakteristeke te saj.

Kopër

Cilësi e mirë, e freskët, i mbajtur pastër. Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Qiqra

Pamja e jashtme: kokrra të shëndosha dhe të plota, me formë dhe madhësi të ndryshme. b. Ngjyra: karakteristike të qiqrës, bezhq deri në kafe të çelët. c. Era dhe shija: pa erë myku e pa shije të hidhur dhe pa erë e shijë të huaj. Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa në të cilën shënohen: • Emërtimi i prodhuesit. • Emri i produktit . • Pesha neto ose vëllimi i produktit. • Data e prodhimit . • Data e skadimit. • Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Kunguj

Kerkohet cilesi e pare te jene te fresketa te mos te shtypur ose me shenja demtimi ose kalbur,ngjyra te karakteristike e kungullit. Per te gjatet kerkohet diametri jo me shume se 5 cm dhe gjatesia 15-20 cm.

Salce

Lloji i salces te jete domate, me ngjyre te kuqe te domates.

Te kete eren karakteristike te domates,pa shenja te tjera.

Te jete ambalazhuar ne kuti teneqe me etike prodhuesi dhe me garncine e shenuar Ambalazhimi 700 gr . Afati skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit

Qepe të thata

Te jete e thate plotesisht ,e paster

Ne madhesi normale jo e vogel me diameter jo me te vogel se 5 cm, e pademtuar apo te kalbura.Te jen e ambalazhuar ne thase jo te mbydhur(tip rrjete) ne peshe deri 15 kg.

Hudhër

Pamja e jashtme: Me pjekuri të plote.Me cipe e bisht të thate, të shendosha e të plota. Demtime mekanike me semundje nuk lejohen. Të ngrira ,të kalbura e të mykura nuk lejohen. Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88 Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.



Rigon:

Te jete I bluar imet, te jete ere te karakteristike, pa lageshtire ne ambalazh (bustina 50 gr).

Vanilje

Pamja: pluhur i thatë. Shija dhe era : te këndshme karakteristike të vaniljes. Ngjyra: Te jete e bardhe. Nuk lejohen papasterti te ndryshme. Lëndë të huaja: nuk lejohen Ambalazhimi: në paketime të vogla , të pastra, pa lagështi, pa erë të huaj, me peshë nga 10gr - 50gr.

Pluhur pjekje

Pamja: pluhur i thatë. Shija dhe era : te këndshme karakteristike për gatim. Nuk lejohen papasterti te ndryshme. Lëndë të huaja: nuk lejohen Ambalazhimi: në paketime të vogla , të pastra, pa lagështi, pa erë të huaj, me peshë nga 10gr - 50gr

Arrë moskati

Pamja: të jenë të thata b. Aroma dhe shija: të këndshme karakteristike të vetë bimës. c. Ngjyra: gri në kafe. d. Papastërti: nuk lejohen. Ambalazhimi: në paketime të vogla, të pastra, pa lagështi, pa erë të huaj, me peshë nga 40gr.

Fasulja

Me kokrra te plota dhe mesatare, te shendosha, te paprekura nga miza, pa erë myku dhe lende te huaj. E etiketuar dhe ambalazhuar sipas standartit, te jete product vendi e fresket dhe e re dhe te zihet shpejt.

Neni 19**Paketimi dhe Dokumentet**

- 19.1** Furnizuesi siguron paketimin e mallrave siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin ose përkeqësimin e tyre gjatë transportit në destinacionin e tyre përfundimtar, siç përshkruhet në Kontratë. Gjatë transportit, paketimi duhet të jetë i tillë që t'i rezistojë ekspozimit ndaj temperaturave ekstreme, kripës dhe reshjeve dhe kushteve të magazinimit. Madhësia dhe peshat e kutisë së paketimit do të marrin parasysh, kur është e përshtatshme, largësinë e destinacionit përfundimtar të Mallrave.
- 19.2** Paketimi, shënjimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në përputhje me kërkesat e veçanta siç parashikohen shprehimisht në Kontratë, përfshirë kërkesat shtesë, nëse ka, të specifikuara në KVK, dhe në çdo kërkesë tjetër nga Blerësi.
- Nëse konstatohet që produktet nuk janë sipas standartit të kërkuar/sipas specifikimeve teknike blerësi ka të drejtën të kthejë mallin dhe ky mall të



zëvendësohet nga furnitoren brenda ditës pa penguar procesin e shërbimit të ushqimit në kopshte dhe cerdhe. Në këtë rast komisioni që pret mallin mban procesverbalin përkatës

Neni 20

Siguracioni

- 20.1** Përveç nëse specifikohet ndryshe në KVK, Furnizuesi duhet të sigurojë që Mallrat që do të dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit të lidhur me prodhimin ose blerjen, transportin, magazinimin dhe dorëzimin, në përputhje me Inkotermat e zbatueshme ose në mënyrën e specifikuar në KVK.

Neni 21

Transporti

- 21.1** Përveçse kur përcaktohet ndryshe në KVK, përgjegjësia për organizimin e transportit të Mallrave do të jetë në përputhje me Inkotermat e zbatueshme.

Neni 22

Inspektimet dhe testet

- 22.1** Furnizuesi do të kryejë me shpenzimet e veta dhe pa asnjë kosto për Blerësin, të gjitha testet dhe / ose inspektimet e tilla të Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to siç specifikohet në KVK.
- 22.2** Inspektimet dhe testet mund të kryhen në ambientet e Furnizuesit ose Nënkontraktorit të tij, në pikën e dorëzimit, dhe / ose në destinacionin përfundimtar të Mallrave, ose në një vend tjetër në vendin e Blerësit siç përcaktohet në KVK. Nëse kryhen në ambientet e Furnizuesit ose Nënkontraktorit të tij, të gjitha lehtësitë dhe ndihma e arsyeshme, duke përfshirë aksesin tek vizatimet dhe të dhënat e prodhimit, do t'u dorëzohen inspektorëve pa pagesë për Blerësin.
- 22.3** Përfaqësuesit e caktuar të Blerësit kanë të drejtë të marrin pjesë në testet dhe / ose inspektimet e përmendura në Nenin 22.2, me kusht që Blerësi të përballojë të gjitha kostot dhe shpenzimet e tij të kryera në lidhje me një pjesëmarrje të tillë duke përfshirë, por pa u kufizuar, të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit.
- 22.4** Kurdoherë që Furnizuesi është i gatshëm të kryejë ndonjë test dhe inspektim të tillë, ai do t'i bëjë një njoftim të arsyeshëm paraprak, Blerësit, duke përfshirë vendin dhe kohën. Furnizuesi do të marrë nga çdo Palë e tretë përkatëse ose prodhues çdo leje ose pëlqim të nevojshëm për t'i mundësuar Blerësit ose përfaqësuesit të tij të caktuar të marrë pjesë në test dhe / ose inspektim.



- 22.5** Blerësi mund të kërkojë nga Furnizuesi të kryejë çdo test dhe / ose inspektim që nuk kërkohet nga Kontrata, por konsiderohet i nevojshëm për të verifikuar nëse karakteristikat dhe performanca e Mallrave përputhen me kodet dhe standardet e Specifikimeve Teknike sipas Kontratës. Blerësi do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Nëse një test dhe / ose inspektim i tillë pengon progresin e prodhimit dhe / ose kryerjen nga ana e Furnizuesit të detyrimeve të tjera të tij sipas Kontratës, Blerësi do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.
- 22.6** Furnizuesi do t'i sigurojë Blerësit një raport të rezultateve të çdo testi dhe / ose inspektimi të tillë.
- 22.7** Blerësi mund të refuzojë çdo Mall ose ndonjë pjesë të tij që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është në përputhje me Specifikimet. Furnizuesi do të ndreqë ose zëvendësojë Mallrat e refuzuar apo pjesë të tyre ose do të bëjë ndryshimet e nevojshme për të përmbushur specifikimet pa ndonjë kosto për Blerësin, dhe do të përsërisë testin dhe / ose inspektimin, pa asnjë kosto për Blerësin, pasi të njoftojë në përputhje me Nenin 22.4.
- 22.8** Furnizuesi bie dakord që ekzekutimi i një testi dhe / ose inspektimi i Mallrave ose ndonjë pjese të tyre, nuk e shkarkojnë Furnizuesin nga garancitë ose detyrimet e tjera sipas Kontratës.

Neni 23


Dëmet e likujduara

- 23.1** Dëmet e likujduara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.
 - b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.
 - c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

Neni 24

Garancia

- 24.1** Furnizuesi garanton që Mallrat nuk kanë defekte që vijnë nga ndonjë veprim ose mosveprim i Furnizuesit ose që vijnë nga skicimi, materialet dhe punimi nën përdorimin normal në kushtet që mbizotërojnë në vendin e destinacionit përfundimtar.




- 24.2** Blerësi përcakton në KVK kohëzgjatjen e vlefshmërisë së garancisë (nëse është rasti), pasi Mallrat, ose ndonjë pjesë e tyre sipas rastit, të jenë dorëzuar dhe pranuar në destinacionin përfundimtar të përshkruar në KVK.
- 24.3** Blerësi do të njoftojë Furnizuesin duke treguar natyrën e defekteve të tilla së bashku me të gjitha provat e disponueshme të tyre, menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se dhjetë ditë nga zbulimi. Blerësi do të sigurojë të gjitha mundësitë që Furnizuesi të inspektojë defekte të tilla.
- 24.4** Pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi duhet, brenda periudhës së specifikuar në KVK, të riparojë ose zëvendësojë me shpejtësi Mallrat ose pjesët e dëmtuara, pa ndonjë kosto për Blerësin.
- Nëse pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi nuk arrin të rregullojë defektin brenda periudhës së specifikuar më sipër, Blerësi mund të kryejë rregullimet e nevojshme me shpenzimet e Furnizimit. Në çdo rast, Blerësi mund të vendosë që të njoftojë Furnizuesin për ndërprerjen e Kontratës.

Neni 25

Zhdëmtimi i Patentës

- 25.1** Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:
- (a) instalimit të mallrave nga Furnizuesi ose përdorimit të mallrave në vendin e dorëzimit të Mallrave;
- dhe
- (b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Mallrat.
- Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Mallrat ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.
- 25.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 25.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.



25.3 Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim,

specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

Neni 26

Kufizimi i Përgjegjësisë

26.1 Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e riparimit ose zëvendësimit të pajisjeve me defekt, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

Neni 27

Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore

27.1 Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 28

Forca madhore

28.1 Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një

mospërbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

28.2 Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

28.3 Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

Neni 29

Modifikimi i Kontratës

29.1 Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

29.2 Blerësi mund t'i paraqesë kërkesë në çdo kohë Furnizuesit, të bëjë modifikime brenda objektit të përgjithshëm të Kontratës në një ose më shumë nga kushtet si vijon:

(a) vizatimet, skicat ose specifikimet, ku Mallrat që do të furnizohen sipas Kontratës duhet të prodhohen posaçërisht për Blerësin;


(b) mënyra e dërgesës ose paketimit;

(c) vendin e dorëzimit; dhe

(d) Shërbimet e Lidhura që do të ofrohen nga Furnizuesi.

29.3 Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përlogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

29.4 Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.



Neni 30

Zgjatja e afatit

- 30.1** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë dërgimin në kohë të Mallrave ose përfundimin e Shërbimeve të Lidhura në përputhje me Nenin 12, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.
- 30.2** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 28, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

Neni 31

Ndërprerja e Kontratës

- 31.1 Njoftim për të korrigjuar**
Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
- 31.2 Ndërprerja për mospërmbushje**
Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:
- (i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 31.1 të këtij neni;
 - (ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të dorëzojë ndonjë ose të gjitha Mallrat brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 30; ose
 - (iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 9, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.
- 31.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**
Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në



31.4 ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.
- c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Mallrat e pranuar dhe Shërbimet e lidhura me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve të lidhura me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 32

Kufizimet e Eksportit

32.1 Pavarësisht nga çdo detyrim sipas Kontratës për të përfunduar të gjitha formalitetet e eksportit, çdo kufizim eksporti që i atribuohet Blerësit, vendit të Blerësit ose përdorimit të mallrave ose shërbimeve që do të furnizohen, të cilat rrjedhin nga rregulloret tregtare nga një vend që furnizon ato mallra ose shërbime, dhe të cilat në mënyrë të konsiderueshme e pengojnë Furnizuesin për të përmbushur detyrimet e tij sipas Kontratës, do ta shkarkojnë Furnizuesin nga detyrimi për të ofruar dërgesa ose shërbime, gjithnjë me kusht që Furnizuesi të demonstrojë në mënyrë të kënaqshme për Blerësin që i ka përfunduar të gjitha formalitetet në kohën e duhur, duke përfshirë aplikimet për leje, autorizime dhe licenca të nevojshme për dërgimin e mallrave ose shërbimeve sipas kushteve të Kontratës.

Neni 33

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 33.1** Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.
- 33.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë

Neni 34

Përfaqësimi i Palëve

- 34.1** Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.



- a) Personi që do të jetë përgjegjës, në emër të **Autoritetit Kontraktor** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jenë **zj.Rudina Kruja** me detyrë specialist pranë Drejtorisë së Arsimit, Rinisë, Kultures dhe Sportit.

cel/tel/fax 0673448819

E-mail: rudina.kruja@bashkiashkoder.gov.al

- b) Personi që do të jetë përgjegjës në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jetë **zj.Entela Lici**.

E-Mail: licisuad12@gmail.com

Telefon: 0673005924

34.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërtimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

34.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

34.4 Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XIII, neni 107, pika 6, "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, **zj.Rudina Kruja** si personi që do të jetë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbljedhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

34.5 Personi përgjegjës duhet të ndjekë me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

- a) harton raportin e zbatimit të zbatimit të kontratës;
- b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
- c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
- d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;



- dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
- e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së.

KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

- 1.1** Blerësi është: **Bashkia Shkodër**
Adresa: Rr. "13 dhjetori", Nr. 1 Shkodër
Telefoni: +35522400150
Numri i faksit: _____
E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al
- 1.2** Furnizuesi është: **"SEAD-SGS"sh.p.k**
Adresa: e Tirane Lagjia Kashar Nr.2,Rruga "Mullishter";
Telefoni: 0673005924
Numri i faksit: _____
E-mail: licisuad12@gmail.com
- 1.3** Gjuha për komunikimet është: **Gjuha shqipe**
Gjuha është: **Gjuha shqipe**

Neni 2

Sigurimi i Kontrates

- 2.1** Sigurimi i Kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2** Sigurimi i Kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: **Brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të Procesverbalit perfundimtar të Marrjes në dorëzim të mallrave.**

Neni 3

Fillimi i Zbatimit



- 3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë nga momenti i nënshkrimit të kontratës mes paleve. Nëse data nuk është e përcaktuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

Neni 4

Inspektimet dhe Testimet


- 4.1 Inspektimet dhe testimet para pranimit të Mallrave do të bëhen:
- 4.2 Autoriteti Kontraktor me Urdhër të Brëndshëm ngre **Komisionin për Marrjen në Dorëzim të Mallrave** të kontraktuara.
- 4.3 Komisioni i ngritur do të bejë verifikimin për sasinë e levruar, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues sipas të gjitha kushteve të përcaktuara në Kontrate si dhe përcaktimeve të bera në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, për pranimin ose refuzimin e mallit.
- 4.4 Për mallrat/mallin që do të rezultojnë konform specifikimeve dhe kushteve të Kontratës, Komisioni i ngritur sipas pikes 4.2, do të hartojë dhe nënshkruajë “**Procesverbalin e Marrjes në dorëzim të mallrave**”. Në këtë rast, do të veprohet sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, pikat 42 e në vijim.
- 4.5 Për mallrat/mallin që nuk do të rezultojnë konform specifikimeve dhe kushteve të Kontratës, Komisioni, i ngritur sipas pikes 4.2, do të hartojë dhe nënshkruajë “**Procesverbalin e Refuzimit të marrjes në dorëzim të mallrave**”. Në këtë rast, do të veprohet sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, pikat 45 e në vijim.

Neni 5

Kushtet e Dorëzimit

- 5.1 Data (t) dhe vendi (et) i dorëzimit të Mallrave dhe pjesëve të kembimit do të bëhet sipas Grafikut të Levritimit, **për gjithë afatin e kohëzgjatjes së Kontratës**. Furnizimi do të bëhet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor (Bashkisë Shkoder) në periudhën e kërkuar prej saj për përdorim dhe në vendin e përcaktuar për magazinim me mjetet e kontraktorit.
- 5.2 Levrimi i mallit do të bëhet brenda nga data e lidhjes së kontratës deri më 31.12.2024.
- 5.3 Autoritetin Kontraktor do të njoftojë Kontraktuesin **2 (dy) ditë** para çdo dorëzimi të Mallrave.
- 5.4 Lajmërimi i dorëzimit duhet të bëhet me shkrim, faks, postë, e-mail etj, tek:
Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkoder.
Tel/Fax:
E-mail: rudina.kruja@bashkiashkoder.gov.al

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



Vendi i dorëzimit të mallrave do jetë në magazina e Bashkisë Shkoder.

Dorëzimi i mallrave do te behet gjate orarit te punes.

Mallrat do të dorëzohen në vendin e dorëzimit të shoqëruara me dokumentat e mëposhtme:

Fatura tatimore e mallit

(Elektronike)

Fletanalizen e mallit

(1 Original ose kopje e noterizuar)

Në se Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, lajmërimi i dorëzimit duhet të përfshijë listën e dokumentave të nevojshme për marrjen e Mallrave dhe të tregojë se ku dhe kur do t'i jepen dokumentat Autoriteti Kontraktor.

- 5.5 Nëse Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, Kontraktuesi duhet të dorëzojë të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave tek:

Neni 6

Çmimi i Kontratës

- 6.1 Çmimi i Kontratës është **9,555,581** (Nentemilion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa tvsh ose **11,466,697.2** (Njembëdhjetemilion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nentëdhjetë e shtatë pike dy) lekë me tvsh.

Neni 7

Kushtet e Pagesës

- 7.1 Pagesa për furnizimin e mallrave, do te behet brenda 30 diteve nga dita e nënshkrimit nga palet të **“Procesverbalit të Marrjes në dorëzim të mallrave”**. Në rast se mallrat nuk do te dorëzohen dhe instalohen në një here të vetme, afati i mesipër fillon nga dita kur do te behet **“Procesverbalit të Marrjes në dorëzim të mallrave”** për mallrat e fundit të dorëzuara.

Faturën/at tatimore lëshuar nga Kontraktuesi

(1 Original)

Procesverbalin/et e Marrjes në dorëzim

(1 Original)

Aktin e refuzimit të mallit (nese ka sasi malli te refuzuar)

(1 Original)

Monedha e pagesës do të jetë: LEK.

- 7.2 Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit të paraqitur nga ai vetë në formë shkresore pranë Autoritetit Kontraktor .

Neni 8

Paketimi dhe Dokumentet

- 8.1 Paketimi, shënjimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë paketave duhet të jetë: **Sipas specifikimeve teknike të dhëna dhe të pranë në dokumentat e tenderit nga kontraktuesi.**



Neni 9

Siguracioni

9.1 Nëse nuk është në përputhje me Inkotermat, mbulimi i sigurimit do të jetë si më poshtë
Siç përcaktohet në nenin 2, kushtet e veçanta të kësaj kontrate.

Neni 10

Transporti

10.1 Përgjegjësia për rregullimin e transportit të Mallrave do të jetë në përputhje me Inkotermat e specifikuar.

Nëse nuk është në përputhje me Inkotermat, përgjegjësia për transportin do të jetë si më poshtë: **Përgjegjësia për transportin do të jetë e kontraktuesit.**

Neni 11

Shërbimet në Lidhje me to

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së Shërbimeve të Lidhura

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR

BASHKIA SHKODËR

Kryetar i Bashkisë

Benet BECI

Perfaqësuar me vendim delegimi

ZV. Kryetar i Bashkisë

Onid BEJLERI



PER OPERATORIN EKONOMIK

“SEAD-SGS” sh.p.k

Administrator Ligjor

Entela LICI

ENTECLA LICI

